

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Mr.Sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Prishtinës, të cilën me autorizim e përfaqëson Arta Mazreku, kundër të paditurës N.T.P. “B. C.”, me seli në Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson R. G., objekti i kontestit shpërblimi i dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës , duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.153/2016 datë 21.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4 korrik 2018, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.153/2016 datë 21.3.2018.

#### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr. 153/2016 datë 21.3.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Komuna e Prishtinës, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr. 67/2014 datë 19.5.2016, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit , me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të mos përmbushjes të kontratës t’ia paguajë shumën prej 31.725.56 €, me kamatë ligjore, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Është obliguar paditësi që të paditurës t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 395.00 €.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë paditësi në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të dy aktgjykimet ajo e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë të ndryshohen dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ose të njëjtat të prishen dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në përgjigje në revizion e paditura ka propozuar që revizioni i paditësit ka propozuar që revizioni i paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimit të goditur, revizionit dhe përgjegjës në revizion, në kuptim të nenit 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Përndryshe objekti i kontestit në këtë çështje juridike është kërkesa e paditësit që i padituri të paguajë shumën prej 317.255,60 €, për shkak të mos përmbushjes së kontratës lidhur në mes të palëve ndërgjyqësve nr.61612152521 të datës 3.10.2012, e cila është e lidhur për shtrimin e rrugës “M. K.” faza e tretë në Prishtinë. E paditura në përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se për mos përmbushjen e kësaj kontrate nga ana e të paditurit ka ardhur për shkak të pengesave të cilat i kanë bërë pronarët e tokave nga do të shtrihej rruga, për të cilën i padituri ka njoftuar paditësin, dhe i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që të zgjedh çështjen e kontestit lidhur me pronarët e tokave të cilët kanë bërë pengesa për fillimin e punëve.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, ka konstatuar se i padituri si rezultat i këtyre pengesave nuk ka pasur mundësi të kryejë punimet në terren dhe nuk është përgjegjës për mos përmbushjen e detyrimit, pasi që i padituri si rezultat i pengesave që janë paraqitur nga pronarët e tokave nga do të shtrihej rruga, nuk ka pasur mundësi t'i ekzekutoj punimet në terren. Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në gjendjen e vetëtuar faktike dhe në kuptim të nenit 17 dhe neni 354 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate ndër detyrimet themelore të porositësit të punimeve të kontrata e ndërtimit është që të siguroj rrethana dhe kushte në mënyrë që kryerësi i punëve mund të ndërmarrë veprime ndërtimore pa u penguar. Paditësi gjatë kryerjes së punimeve ka njoftuar porositësin e punimeve për pengesat e paraqitura por porositësi i punëve nuk ka ndërmarrë asgjë në drejtim të evitimit të këtyre pengesave.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë të vendosjes sipas ankesës së paditësit, ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë të drejt është aplikuar e drejta materiale kur është vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 215 të LPK, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paditësit në revizion se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësit ka bërë shkelje nga neni 182 par. 2, pika (n) të LPK, nuk qëndrojnë nga arsyet se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe duke dhënë arsye bindëse dhe të bazuara në ligj.

Në bazë të provave të administruara dhe nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri si kryes i punimeve ka filluar punimet në bazë të kontratës, ashtu siç ka qenë e paraparë me kontratën lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse, mirëpo paditësi në cilësinë e operatorit ekonomik nuk ka përmbushur kushtet për të paditurin për të filluar punët e ndërtimit të rrugës në rrugën “M. K.” faza e tretë. Mbikëqyrësi i punimeve është njoftuar për pengesat e paraqitura, çka kjo konstatohet edhe nga ditari ndërtimor, dhe se me kërkesën e menaxherit të projekti më datën 7.11.2012 i padituri ka ndërpre punimet. Njëherit i padituri është drejtuar me kërkesë Kuvendit Komunal të Prishtinës më datë 16.11.2012 me kërkesë që të zgjidhen problemet dhe të krijohen kushtet për vazhdimin e punimeve. I padituri ka rifilluar punimet më 16.4.2013 por përsëri i ka ndërpre për shkak të reagimit nga qytetarët për shkaqe pronësore dhe si rezultat i këtyre më 17.5.2013 janë ndërpre punimet. Prandaj, thëniet e revizionit se gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike ka mbështetur në deklarimet dhe provat e propozuara nga ana e të paditurit dhe nuk kanë marrë për bazë provat e dorëzuara nga paditësi nuk qëndrojnë.

Palët kontraktuese sipas kontratës së nënshkruar për kryerjen e punimeve kanë bërë sigurimin e ekzekutimit në kompaninë e sigurimeve dhe se si garantues dhe përgjegjës për shumën prej 31.725,56 €, është kompania e sigurimeve si garantues dhe se paditësi ka mund të bëjë ekzekutimin e garancionit të garantuar.

Gjykata pretendimet tjera në revizion sa i përket gjendjes faktike nuk i ka vlerësuar për arsye se revizioni në kuptim të nenit 214.2 të LPK, nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.22/2018, më 4 korrik 2018

Kryetari i kolegjit,  
Erdogan Haxhibeqiri

